



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:145891

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05496465

Ac.nr.310/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca - Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.E., nga fshati B..., Komuna e Kaçanikut, rruga "...", kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a, (KEDS) në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ardian Jashari, jurist, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.150/16, i datës 02.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a, (KEDS) në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.150/16, i datës 02.12.2019, në pikën I (një) dhe III (tre) të dispozitivit, VËRTETOHET.

II. Aktgjykimi i ankimuar në pikën II (dy) të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.150/16, i datës 02.12.2019 në pikën I (një) të dispozitivit e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit E.E., nga fshati B..., Komuna e Kaçanikut dhe e ka detyruar të paditurën Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a, në Prishtinë - Distrikti Ferizaj, që paditësit t'ia paguaj shumën prej 3,806.43 € euro në emër të dëmit material për djegien e shtëpisë dhe ate me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 25.11.2019 (data e seancës kryesore), e deri në pagesën definitive.

Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e gjykuar dhe atë për shumën prej 1,631.34 Euro, në emër të dëmit material. Në pikën III (tre) e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën nga pika I e këtij dispozitivi të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 590.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë ose vet ta vendos çështjen duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi E.E., me datë 22.09.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a, në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.150/16, i datës 02.12.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se për vërtetimin e bazës së kërkesëpadisë dhe vërtetimin e përgjegjësisë së të paditurës ka bërë nxjerrjen dhe administrimin e provës siç është procesverbali i Drejtorisë për Emergjencë 07 Nr.16-28080/16 i hartuar me rastin e daljes në vendin e ngjarjes dhe vlerësimin e shkaqeve të shpërthimit të zjarrit, në të cilin është konstatuar data dhe ora e shpërthimit të zjarrit dhe procesverbali i Drejtorisë për Emergjencë 07 Nr.16-28080/16 i datës 15.06.2016 në të cilin është konstatuar djegia e shtëpisë së këtu paditësit me strukturë dhe dimensione të caktuara. Gjykata poashtu për vërtetimin e shkaktarit të zjarrit ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e elektros nga eksperti O.H., nga e cila ekspertizë ka rezultuar se deri tek incidenti ka ardhur me veprimet e të dy palëve ndërgjyqëse edhe ate: kontribiti i të paditurës është furnizimi me energji elektrike jo cilësore e cila ka ndikuar të vie deri tek zvogëlimi i nivelit të izolimit të kabllot elektrike të furnizimit, shkaktimin e lidhjes së shkurt elektrike, harkun elektrik të përcjellë me temperatura të larta dhe ndezjen e materialit drunor në tavan të shtëpisë, i përcjellë pastaj në pjesët tjera të shtëpisë. Ka shtuar poashtu se vendosja e shtyllave nuk është bërë sipas standardeve të lejuara, sepse shtyllat duhet të jenë të fikësuar dhe të pa lëvizshme dhe përcuesit duhet të jenë adekuat. Ndërsa

kontributi i paditësit në shkaktimin e këtij incidenti konsiston në instalimin jo profesional ngase kablloja prej shtyllës elektrike e deri tek njëtori duhet të jetë e pa ndërprerë, e në rastin konkret kablloja e cila vjen nga shtylla deri tek njëtori ka qenë e vazhduar.

Gjykata në fund ka shtuar se bazuar në ekspertizën e elektros ka ardhur në përfundim se përgjegjësinë primare e mban e paditura sepse është pronare e njëtorit elektrik dhe ka për detyrë të kujdeset për lidhjen nga njëtori deri tek shtylla elektrike. Pastaj vendosja e shtyllave nuk është bërë sipas standardeve të lejuara sepse shtyllat duhet të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme dhe përçuesit duhet të jenë adekuat, çka në rastin konkret tek vendi ku është djegur shtëpia e paditësit eksperti ka konstatuar se ka parë shtylla të lakuara, andaj bazuar në dispozitën e nenit 136 dhe 155 të LMD-së, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Përkitazi me pjesën refuzuese gjykata ka arsyetuar se e ka refuzuar një pjesë të kërkespadi së paditësit mbi shumën e gjykuar për shkak të kontributit të paditësit në shkaktimin e incidenti dhe ate për shkak të instalimit jo profesional, ngase kablloja prej shtyllës elektrike e deri tek njëtori duhet të jetë e pa ndërprerë, e në rastin konkret kablloja e cila vjen nga shtylla deri tek njëtori ka qenë e vazhduar (pra e ndërprerë).

Për vërtetimin e lartësisë së kërkespadi së gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë të ndërtimtarisë për vlerësimin e dëmit nga eksperti Ibrahim S. Hoxha, inxhinier i ndërtimtarisë, i cili ka vlerësuar se dëmi në shtëpinë e paditësit arrin shumën prej 5,437.77 Euro. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ekspertizave në tërësi ua fali besimin pasi të njëjtat janë punuar në mënyrë profesionale dhe janë mjaftueshëm të argumentuara.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike po ashtu del të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë.

Meqenëse nuk kishte pretendime ankimore për shkelje të dispozitave gjykata i vlerësoi vetëm ato për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare për të cilat konstatoi si më sipër.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar apo jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ngase kjo gjykatë me shikimin dhe analizimin e provave shkresore të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur tek gjykata e shkallës së parë vjen në përfundimin se gjykata e shkallës së parë ka arritur që të provoj në tërësi dhe në mënyrë të drejtë themelësinë e kërkespadi së si dhe lartësinë e saj për pjesën e aprovuar të kërkespadi së si dhe pathemelësinë e kërkespadi së për pjesën e refuzuar, ku në arsyetimin e aktgjykimit të ankimit ka dhënë edhe arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pas ndikim në mënyrën e vendosjes.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit themelësia e kërkesëpadisë del se është provuar në bazë të ekspertizës së ekspertit të elektros Ing. O.H., e datës 13.11.2017 dhe sqarimeve të mëtejshme të bëra gjatë seancës gjyqësore, të cilës edhe ja ka fal besimin e plotë, në bazë të së cilës është konstatuar dhe vërtetuar se shkak i shkaktimit të zjarrit në shtëpinë e paditësit ishte furnizimi me energji elektrike jo cilësore e cila ka ndikuar në zvogëlimin e nivelit të izolimit të kabllos elektrike të furnizimit, shkaktimin e lidhjes së shkurt elektrike, harkun elektrik të përcjellë me temperatura të larta dhe ndezjen e materialit drunor në shtëpinë e paditësit dhe se vendosja e shtyllave elektrike në lokacionin ku gjendet shtëpia e paditësit nuk është bërë sipas standardeve të lejuara ngase shtyllat duhet të jenë të fikësuara dhe të pa lëvizshme, çka kjo e ka bërë të paditurën përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditësit. Gjykata e shkallës së parë poashtu nga provat e nxjerra dhe administruara në procedurën e provave ka vërtetuar faktin se edhe paditësi ka kontribuar në shkaktimin e incidentit dhe ate për shkak të instalimit jo profesional ngase kablloja prej shtyllës elektrike e deri tek njëtori ka qenë e vazhduar (me ndërprerje) e që duhet të jetë e pa ndërprerë. Mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka bërë ndarjen e përgjegjësisë dhe ate për të paditurën me përgjegjësi primare për dëmin e shkaktuar e ka detyruar që paditësit t'ia kompensoj dëmin në shumë prej 3,806.43 Euro, ndërsa për shkak të kontributit në shkaktimin e incidentit paditësit ia ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesës së parashtruar me padi në shumë prej 1,631.34 Euro.

Lartësia e kërkesëpadisë po ashtu del se është provuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, pasi që në bazë të ekspertizës së ekspertit përkatës të ndërtimitarisë është konstatuar se lartësia e dëmit i cili i ishte shkaktuar paditësit kap shumën prej 5,437.77 Euro.

Mendimit profesional të dhënë nga eksperti i elektros të cekur si më lart dhe eksperti i ndërtimitarisë, besimin e plotë ja fal edhe Gjykata e Apelit, pasi që kjo gjykatë konsideron se mendimi i tyre është i qartë, i plotë, në përputhje me provat tjera shkresore.

Rrjedhimisht nën rrethanat e tilla edhe sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura mban përgjegjësi objektive lidhur me dëmin e shkaktuar paditësit, pasi që e njëjta si person juridik e cila si veprimtari të vetën ka operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe zhvillimin e transmisionit në mënyrë që të ofroj siguri në operimin e sistemit dhe siguri në furnizim me energji elektrike dhe mbi këtë bazë e njëjta duhet t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar paditësit, për shkak se për sendin e rrezikshëm ose veprimtarinë e rrezikshme nga i cili rrjedh rreziku i shtuar, ligjërisht çdoherë duhet të përgjigjet zotëruesi i saj, përkatësisht personi që merret me të, me përjashtim të rasteve kur para gjykatës mund të vërtetohet se dëmi nuk ka ndodhur me fajin apo lëshimet e tij.

Të pabazuara qëndrojnë pretendimet e palës së paditur se e njëjta nuk është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditësit, ngase me dispozitën e nenit 12 par. 1 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji nr.03/L-201), i cili ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të dëmit dhe krijimit të raportit juridiko civil në mes të këtu palëve ndërgjyqëse, shprehimisht përcaktohet se: „ *Operatori i Sistemit të Transmisionit do të jetë përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmisionit dhe interkonektorëve të tij me sisteme tjera, në mënyrë që të ofrojë siguri të operimit të sistemit dhe siguri në furnizim me energji elektrike si dhe*

menaxhimin e rrjedhave të energjisë në sistemin e transmisionit, rrjedhave ndërkufitare dhe të gjitha kongestionet që mund të paraqiten, duke marrë parasysh këmbimet me sistemet e interkonektuara, në mënyrë që të mbahet balanci mes furnizimit dhe kërkesës dhe të sigurohet eficienca ekonomike e menaxhimit të rrjedhave të energjisë”.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit njëjtë siç ka ardhur në përfundimin juridik gjykata e shkallës së parë, gjen mbështetje në dispozitën e nenit nenin 136 par.1, neni 140, 154 dhe 155 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Me dispozitën e nenit 136 par.1 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve shprehimisht përcaktohet se: „*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Me dispozitën ligjore të nenit 140 të LMD shprehimisht parashihet: „*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*”; me dispozitën e nenit 154 parashihet se: „*Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit*”; me dispozitën ligjore të nenit 155 të LMD përcaktohet se: „*Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të*”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore të cekura si më lart, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka aplikuar edhe të drejtën materiale, pasi që paditura ka për detyrim që paditësit t’ia bëjë kompensimin e dëmit në shumën e gjykuar si në pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe për kamatën e gjykuar, pasi që kamata del të jetë vendosur në përputhje të plotë me dispozitën e ligjit material të nenit 382 të LMD-së, pra kamata është përcaktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë ligjore.

I drejtë del të jetë vendimi mbi shpenzimet e procedurës i cili është në përputhje me dispozitën e nenit 452 të LPK-së dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i ankimuar në pikën II të dispozitivit nuk është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Apelit për shkak se në bazë të thënieve nga ankesa kjo gjykatë ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur në këtë pjesë.

Numri i lëndës: 2019:145891
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05496465

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.310/20, me datë 12.03.2024

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v